

the Old Testament, he added, referring to the daily reading taken from the First Book of Samuel. Neither must we allow our hearts to be softened by worldliness, the Pope said: our hearts must simply be open to the Word of God, open to receiving it, in order not to move away from being chosen by God. Let us ask, Pope Francis concluded, for the grace to overcome our own selfishness, our own desire to do as we please: let us listen instead to the Word of God, which will lead us on the path of truth.

Papa: i krishteri nuk e lë mënjanë Fjalën e Zotit, për të ndjekur atë, që është më në modë



Ata, që kanë dhuratën të jenë bij të Zotit, nuk mund ta ‘shesin’ këtë dhuratë, për hir të ‘normalitetit’ të keqkuptuar, i cili të shtyn ta harrosh Fjalën e Zotit e të jetosh sikur Ai i Lumi të mos ishte fare. Ky, reflektimi i Papës Françesku, në homelinë e Meshës, kremtuar sot paradite në Shtëpinë e Shën Martës, në Vatikan. Në qendër të vëmendjes së Papës, tundimi që të shtyn të dukesh ‘normal’, bir i botës, kur, në të vërtetë, je bir i Zotit. E kjo do të thotë ta harrosh Fjalën e Atit e të ndjekësh fjalën njerëzore, fjalën që do zemra jote, duke vendosur “ta shesësh” dhuratën e të zgjedhurit, për t’u bërë ‘si gjithë bota’. Këtë tundim populli hebre i Besëlidhjes së Vjetër e pati jo një herë, kujtoi Papa Françesku, duke u ndaluar, më pas, tek fragmenti i Liturgjisë, shkëputur nga Libri i Samuelit. Në të tregohet sesi krerët e popullit i kërkojnë Samuelit, tashmë të motuar, të zgjedhë për ta një mbret të ri, duke pretenduar të vetqeverisen. Në këtë çast, vërejtj Papa, populli u tundua ta flakte tutje Zotin; jo vetëm të mos ia dëgjonte Fjalën, por ta mohonte. E fraza, që flet vetë për këtë largim nga Hyji, nënvizoi Papa, është ajo, që thonë pleqtë e Izraelit: duam një Mbret-Gjykatës, që të jemi, kështu, edhe ne, si gjithë popujt. Ja pra, nënvizoi Papa, e flakën Zotin e dashurisë, e flakën hirin e popullit të zgjedhur e deshën të ecin sipas mendësisë së botës, pak a shumë siç bëjnë mjaft të krishterë të ditëve tona: **“Normaliteti i jetës kërkon nga i krishteri besnikëri ndaj hirit të të zgjedhurit, kërkon të mos e shesë këtë hir,**

për të shkuar drejt rrafshmit, sipas mendësisë së botës. Ky ishte tundimi i popullit të zgjedhur, e ky, edhe yni. Shpesh e harrojmë fjalën e Hyjit, harrojmë ç’na thotë Zoti, e zëvendësojmë me fjalët e modës, apo jo?. Edhe fjala e telenovelës është e modës, e marrim edhe këtë, pse më e këndshme! Apostazia është pikërisht mëkati i shkëputjes nga Zoti; e qartë, apostazia, shihet qartë. E kjo është më e rrezikshmja, mendësia e botës, sepse është më e hollë”. Vërtet i krishteri duhet të jetë normal, siç janë normalë gjithë njerëzit, pohoi Papa Françesku, por, ngulmoi, ka disa vlera, të cilat i krishteri nuk mund të mos i mbrojë. I krishteri duhet ta ruajë në shpirt Fjalën e Zotit, që i thotë: “Ti je biri im, je i zgjedhur, unë jam me ty, eci me ty”. Duhet t’i bëjë ballë, prandaj, tundimit, si në episodin e Biblës, për ta konsideruar veten viktimë të një farë kompleksi inferioriteti e për të mos e ndjerë veten popull normal: **“Tundimi e bën zemrën gur; e kur zemra është e ngurtë, kur nuk është e hapur, Fjala e Zotit nuk mund të hyjë në të. Jezusi u thoshte atyre të Emausit: ‘Të pamend e të ngadalshëm në të kuptuar’. E kishin zemrën gur, nuk mund ta kuptonin Fjalën e Zotit. E mendësia e botës e zbut zemrën, por e zbut keqas; zemra e zbutur kësisoj nuk është kurrë zemër e mirë! I mirë është ai, që e ka zemrën të hapur për Fjalën e Zotit, që e merr. Si Zoja e Bekuar, që i meditonte të gjitha këto gjëra në zemër të vet, na kujton Ungjilli. Duhet marrë Fjala, për të mos u larguar nga rruga e të zgjedhurve”.** Ta kërkojmë, atëhere, përfundoi Papa, hirin për t’i kapërcyer mbylljet tona, egoizmin tonë; egoizmin, që më shtyn të bëj ashtu, si më pëlqen, ashtu si dua unë: **“Të kërkojmë hirin për t’i kapërcyer e hirin e butësisë shpirtërore, të aftësisë për t’ia hapur zemrën Fjalës së Zotit e për të mos bërë, si bënë këta vëllezërit tanë, që e mbyllën zemrën, sepse qenë larguar prej kohe nga Hyji e prej kohe nuk e dëgjonin, as nuk e kuptonin Fjalën e Zotit. Zoti na dhëntë hirin e një zemre të hapur, për ta pranuar Fjalën e Tij, për ta medituar gjithnjë e për të marrë, kështu , udhën e vërtetë!”.**

GUARDIAN ANGEL PRAYER



Engjëlli i Zotit, që je rojtari im,
pasi Hyji, për mëshirë të vet,
më ka lënë nën mbrojtjen tënde,
ti sot më shndrit, më mbaj,
më ruaj e më sundo. Amen.

BEQIRI
PROFESSIONAL CORPORATION

Ylli BEQIRI CPA.CGA

Tel: 416-854-9156
Fax: 1-888-838-7736
974 The Queensway,
Toronto ON M8Z 1P6
ybeqiri@sympatico.ca
www.beqiriaccounting.com



Violeta Selmanaj, Broker
Tony Selmanaj, Sales Representative

Per Shitje, Blerje, Qera Shtëpi, Condo A Po
Biznese Lutemi Na Kontaktoni (Shume Vite
Eksperience Ne Toronto Dhe Rrethinat)

In House Mortgage Broker 25 Years
Experience Special Rates Through
Violeta and Tony Selmanaj For Fully
Qualified Applicants.

*** Call for Details**

Direct (416) 553-5044
Office: (905) 279-8300
Email: vselmanaj@trebnet.com

ROYAL LEPAGE Realty Centre, Brokerage®
2150 Hurontario Street Mississauga, ON L5B 1M8





Misioni Shqiptar
'E Lumja Nënë Tereza'

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Qengji i Hyjit!


19 JANAR 2014



Në atë kohë, Gjoni e pa Jezusin duke ardhur kah ai e tha: “Ja Qengji i Hyjit! Ky ia shlyen mëkatin botës! Ky është ai për të cilin thashë: ‘Mbas meje vjen një njeri, i cili është më i madh se unë, sepse ishte përpara meje!’ Nuk e kam njohur as vetë, por arsyeja pse erdha e jam kah pagëztoj me ujë është që ky t’i zbulohet Izraelit.” Gjoni dëshmoi edhe: “E pashtë Shpirtin Shenjt kah zbreti prej qiellit porsi pëllumb dhe zuri vend mbi të. Unë nuk e njihja atë, porse Ai që më dërgoi të pagëztoj me ujë, Ai edhe më tha: ‘Në atë që të shohësh se zbret Shpirti Shenjt dhe zë vend në të, ai është që pagëzon me Shpirtin Shenjt.’ Unë e pashtë dhe dëshmoj: Ky është Biri i Hyjit.” *Gjn 1, 29-34*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN’S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown’s Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: **www.ourladyofmm.com** ose kunsulto harten e ketushme.



Kalendari liturgjik...

20	Janar	Shen Fabiani
21	Janar	Shen Anjeza
23	Janar	Shen Klementi
24	Janar	Shen Françesku i Salesit
25	Janar	Kthimi i Shen Palit

Femijet per Kungim te Pare dhe Krezmim...

Femijet qe rregjistrohen per Kungim te Pare (First Communion) dhe Krezmim (Confirmation) duhet te sjellin kopie te Çertifikates se Pagezimit.

Hakun e Kishes per vitin 2013

e kane dhene:		
Don Gjovani K.	Kokona	
Agron	Vata	
Aleks	Coku	
Aleks	Stolaj	
Aleksander&Adrian	Cukaj	
Alfons	Tarazhi	
Alfred	Shllaku	
Altin	Miri	
Anton	Brunga	
Anton	Vulevic (Vulaj	
Anton	Malaj	
Anton & Violeta	Selmanaj	
Arben	Toma	
Arben	Marku	
Arben	Pepa	
Astrit & Ermira	Simeqi	
Beniamin	Hasko	
Dod	Ndreu	
Edi	Linadi	
Edmond	Kacorri	
Elvis	Bzhetaj	
Enton	Nesha	
Erion	Tase	
Fabian	Pillumaj	
Flamur	Brajoviq	
Florenc	Duro	
Fred	Kalaj	
Gac	Gjoka	

Gazmend	Gjidoda
Gjek & Lec	Gashaj
Gjergj	Gjinaj
Gjergj & Barbara	Nikolla
Gjovalin	Luli
Gjovalin	Melaj
Gjovalin & Sandra	Selmani
Ilir	Shyti
Ilir	Daka
Ilir	Gjokaj
Jetnor	Smakaj
Kreshnik	Malaj
Lek	Selmani
Leke	Kapllaj
Linda	Kalavaci
Ljuc	Juncaj
Luigj	Groshi
Luigj	Lallinaj
Luk	Gjolaj
Malot	Hasaj
Marin	Muzhani
Mario	Martini
Mark	Ndoci
Mark	Shkreli
Martin	Vuktilaj
Martin	Pjetri
Ndok	Macaj
Nikolin	Vukelaj
Nua	Selmani
Nue	Nikci
Nush	Kacaj
Pal	Rransburgaj
Paulin	Marku
Paulin	Lukani
Petrit (Pero)	Ujka
Pjerin	Kalaj
Pjeter	Preka
Pjeter	Tunaj
Pjeter & Bep	Dreshaj
Prek	Lekaj
Prek	Kacaj
Prek	Gjonaj
Prek	Spaqi
Prel	Pepushaj
Rozina	Kalaj
Rrok	Gjoni
Shtjefen	Gjuravçaj
Silvan	Nerhati
Sokol	Vushaj
Sokol	Ujka
Sokol	Gashaj
Taulant	Dedja
Tom	Merditaj
Tome	Ivanaj
Tony	Isufaj
Valentin	Malaj
Valete (Vladimir)	Gjokaj
Vasel	Dreshaj
Viktor	Dokaj
Viktor	Pleti
Vitor	Mernacaj
Vladimir	Doda
Zef	Lulaj
Zef	Deklaj
Zef	Skrela (Shkreli)
Zef	Prela

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!
Hakun e Kishes per vitin 2014 e ka dhene Prek Lekaj.

Per Hakun e Klshes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese**

pjese gjate vitit. Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.

Mikrofoni i Papës: në 546 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut



Kur përkujtojmë një njeri të dashur në përvjetorin e vdekjes, simbas zakoneve tona të lashta, shkojmë ndër varre. Po njeriu, që duam të përkujtojmë sot, nuk ka varr. Varri i tij u hap pak pas vdekjes, e eshtrat u përdorën si hajmali pavdekësie. Ndërsa figura e tij vigane u riduk në bronz në sheshet e trojeve arbnore e të qyteteve të mëdha të botës, që shpëtuan falë shpatës së tij. Në Romë mund ta takojmë në Sheshin Albania, gjithnjë mbi kalin e bronztë, Atlet

i Krishtit, roje e përjetshme e Evropës së krishterë. Po në Qytetin e Amshuar ka edhe një kënd tjetër, ku mund ta takojmë: Sheshi Skënderbej. Nisemi, prandaj, me mikrofoning tonë, për një bisedë simbolike. Përshkojmë rrugët e rrugicat e ngatërruara si pëlhurë merimange të Romës së lashtë e të re, nga Sheshi i mrekullueshëm Navona, te Shatërvani i Trevit. Që këtu, duke përshkuar rrugën Lavatore, ndalemi tek një rrugicë e ngushtë dredha-dredha, me shtëpi të larta, të lashta, në të dy krahët. Është Rrugica Skanderbeg, e zhytur në heshtjen e plotë të muzgut romak. Shkelim mbi atë kalldrëm, ku 546 vjet më parë gurët lëshojshin shkëndija nën rrahjen e potkonjve të kuajve e muret tundeshin nga parakalimi i një grushti trimash, që vinte të trokiste në portën e Papës, për të shpëtuar me Të, qytetërimin evropian. Arrijmë. Na duket sikur shkelim në troje të trashëguara nga etërit, në sa i afrohemi Sheshit Skanderbeg. E aty na pret vetë Kryetrimi, portreti i të cilit, ndër më të ngjashmit, na shikon nga qemeri i portës. Ndodhemi para pallatit Skënderbe, dikur bujtinë e han, sot muze i makaronave. Jemi mësuar të intervistojmë politikanët tanë, që vijnë në trokasin në portën e Papës, që kur u shemb komunizmi. Na duket, prandaj, e arsyeshme ta bisedojmë edhe Skënderbeun. Të sigurt se ka gjithnjë diçka të re për të thënë. Na fton të hyjmë aty, me një hije të lehtë ironie në fytyrën ende të re, duke parë makaronat e të gjitha tipeve, që e rrethojnë, në vend të shpatave, heshtave e kuajve. E pyesim për vizitën e tij të fundit në këtë vend. Na përgjigjet: “Të kthehemi në vitin 1463. Lidhja Shqiptare nënshkroi një paqe fiktive. Po unë e lajmërova Papën se isha gati ta filloja luftën kurdoherë ta shikonte të nevojshme. Menjëherë pas, Piu II u bëri thirrje gjithë të krishterëve të rroknin Kryqin kundër turqëve. Po pak iu përgjigjen kësaj thirrjeje për të filluar kryqëzatën, të ngatërruar, siç ishin, me zënkat e tyre të përjetshme, veç meje e Mathias Korvinit të Hungarisë. Papa u nis për Raguzë. Por fati nuk desh ta kryente veprën e nisur: vdiq rrugës, e bashkë me të, u varros edhe shpresa e fundit e një fronti të përbashkët kundër armikut otoman”. “Po Ju, ku ndodheshit në atë kohë?” - vijnë. “I dëshpëruar nga apatia dhe verbimi i botës së krishterë, i veshur si ushtar i thjeshtë, erdha këtu, ku jemi tani. Një vargan i gjatë kardinajsh e ipeshkvijsh kishin dalë të më prisnin. Kjo rrugë, tani krejt e heshtur, atë natë tundej nga brohoritë

plot entuziazëm të turmës së madhe të romakëve”. “E pastaj?”. “Pastaj, në Bazilikën e Shën Pjetrit u mbajt një kremtim madhështor. Papa Piu II më dha, me dorën e vet, një shpatë nderi, të bekuar. Por si ndihmë financiare u mbledhën vetëm 7000 dukatë. M’u desht të kthehesha menjëherë për t’i dalë zot Krujës së rrethuar. Ishte fitorja ime e fundit”1. Kështu tha Skënderbeu dhe, duke ia ngulur përsëri sytë mikrofoning tonë, shtoi: “Mikrofoni i Papës... Edhe një herë Papa më jep mundësinë t’i kujtoj botës ca të vërteta, që më duket se i ka harruar. Nësa në Atdhe, në vend që të më kujtojnë, vijnë të më përgojnë. Historianët e sulltanit hapin përsëri qitapet, në të cilat historia është e shkruar përmbys. Po fatmirësisht, në krah tjetër, Papët vijnë të hapin portat e arkivave, ku ruhet historia e vërtetë e njerëzimit. Për atë që kërkon ndershmërisht të vërtetën!”. Tha kështu, e heshti. E ne nuk mundëm të mos kujtojmë Papën Kalisti III, që e përmbloodhi me pak fjalë rëndësinë historike të luftës së këtij Burri, që na shikonte ashtu, i rrethuar me makaronat italiane, të cilat në kohë të tij do t’i kishte pranuar me kënaqësi si ndihmë humanitare për popullin e vet, gjithnjë unshëm: “Si një pendë e patundshme, Ai ndaloi furinë e sulmeve turke dhe i pengoi ta pushtonin Evropën kristiane. Emër i madh, që meriton të përmendet në Tempullin e Kujtimit”. Takimi ka përfunduar e ne kthehemi, nëpër të njëjtën rrugë, duke menduar me vete: “Ç’do të ndodhte sot me Evropën, po të mbetej ballëpërballë urdive të vjetra e të reja, me një shpatë, një mburojë e një pritë të vetme, atë të popullit të vogël shqiptar e të njërit nga politikanët e tij, që erdhën njëri pas tjetrit në krye të vendit, që nga vdekja e Atletit të Krishtit?”. 1 Tajar Zavalani, Historia e Shqipërisë, Drini Publications LTD, 1957, fq 202-204 (Radio Vatikani)

Pope Francis: Don’t forsake the gift of being God’s children



(Vatican Radio) We must not sell out the gift of being God’s children for a distorted sense of normality. These were the words of Pope Francis at Mass on Friday morning in the Vatican’s Casa Santa Marta. As Christians, Pope Francis said, we must actively strive against the normality of our everyday lives to remain faithful to God’s choosing. We must not sell out to the temptation of worldliness, of living as if God didn’t exist. We often forget the Word of God, Pope Francis

continued, we forget what the Lord says, and we listen instead to whatever word is more fashionable, more fun. This temptation, the Pope said, is more dangerous than an outright renouncing of faith, because it is more subtle, and less clear. It is true, he recognised, that Christians must be normal people, but they must also bear in mind the Word of God which says to them ‘you are my people, I have chosen you, I am by your side’. We must resist the temptation of feeling inferior to normality, Pope Francis explained, because this temptation hardens the heart, and when the heart is hardened, the Word of God cannot enter. This was the temptation of the Jewish people in